



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1760/11 Prot.

Tiranë, më 27.06.2017

Lënda : Lidhur me kandidatët pedagogë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Drejtuar: Z.Xhezair Zaganjori
Kryetar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës

Për dijeni: Z.Sokol Sadushi
Drejtor i Shkollës së Magjistraturës

TIRANË

I nderuar,

Në vijim të procesit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në kushtet kur në përfundim të procesit të aplikimit dhe të dy rishpalljeve rezulton se nuk është plotësuar numri minimal i kandidaturave, sipas parashikimeve të neneve 53 dhe 151 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në datën 27.6.2017 u është drejtuar përsëri institucioneve të arsimit të lartë me kërkesën për të rishpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit.

Me këtë rast, duam të sjellim në vëmendjen tuaj se, pas përzgjedhjes dhe votimit të anëtarëve të organeve për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rezulton se kandidatja e propozuar nga Shkolla e Magjistraturës për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, znj.Alma Faskaj Vokopola, është zgjedhur komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 134, pika 4, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Shkolla e Magjistraturës duhet të kryejë procedurën për thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit dhe përzgjedhjen e një kandidati tjetër për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Alban BRATI

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

